



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI KOMBËTAR I UJIT

Nr. 1465 Prot.

Tiranë, më 07. 10. 2024

V E N D I M

Nr.6, datë 27.9.2024

PËR

“MIRATIMIN E PROJEKTPLANIT TË MENAXHIMIT TË RISKUT NGA PËRMBYTJET, BASENI LUMOR ISHËM”

Në mbështetje të pikës 2, të nenit 70, të ligjit nr.111/2012 “Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore”, i ndryshuar, të Kreut 3 dhe 4, të Shtojcës III, të vendimit nr.1015, datë 16.12.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për përmbajtjen, zhvillimin dhe zbatimin e strategjisë kombëtare të menaxhimit të burimeve ujore, të planeve të menaxhimit të baseneve ujore dhe planeve të menaxhimit të rrezikut nga përmbytjet”, paragrafit “vii”, të shkronjës “b”, të pikës 1, të kreut III, të vendimit nr.221, datë 26.4.2018, të Këshillit të Ministrave, “Për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë së Menaxhimit të Burimeve Ujore”, me propozimin e Agjencisë së Menaxhimit të Burimeve Ujore, Këshilli Kombëtar i Ujit

V E N D O S I:

1. Miratimin e Projektplanit të Menaxhimit të Riskut nga Përmbytjet, Baseni Lumor Ishëm sipas aneksit 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.
2. Ngarkohet Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore, për publikimin Projektplanit, koordinimin me autoritetet përkatëse, si edhe zhvillimin e procedurave të vlerësimit strategjik mjedisor.

3. Ngarkohet Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore, që pasi të trajtojë të gjitha komentet në lidhje me Projektplanin, të disponuara gjatë periudhës 6-mujore të publikimit, të paraqesë për miratim planin përfundimtar në Këshillin Kombëtar të Ujit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI

BELINDA BALÇUKU



**AGJENCIA E MENAXHIMIT TË BURIMEVE UJORE
DREJTORI I PËRGJITHSHËM**

GERTA LUBONIA

